



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 11.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 10.11.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “EJONA” për aktivitetin :”**Vendosja,rregullimi dhe riparimi i ashensoreve**” dhe me numër të prokurimit: 616 -20-2517-521 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa e Operatorit Ekonomik “EJONA” e datës 09.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit:” **Vendosja,rregullimi dhe riparimi i ashensoreve**” dhe me numër të prokurimit: 616 -20-2517-521 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së ,dërguar me datën 03.11.2020 dhe publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. Vertetohet Vendimi i publikuar me datë: 03.11.2020;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “EJONA” me datë 09.11.2020 ka parashtruar ankesën, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:” **Vendosja,rregullimi dhe riparimi i ashensoreve**” dhe me numër të prokurimit: 616 -20-2517-521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 11.11.2020, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Pretendimet tuaja lidhur me faktin se dokumentet e dorezuara-referencat për stafin janë plotësim i tenderit janë të pa bazuara,pasi që nuk ka rendesi kur ato dokumente janë leshuar,por me rendesi është koha e cekur që anëtarët e stafit kanë menaxhuar punë dhe projekte të natyrës së kerkuar dhe se të gjitha këto e kanë bazën para datës së dorëzimit të tenderit,pasi që janë të cekura në CV-të e stafit që janë pjesë e tenderit.Ua perkujtojmë se sqarimet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktues janë bazuar në nenin 72 të LPP-se dhe nenin 39.8.13 të RRUOPP-ik.Pretendimi lidhur me referencën shtese të OE-ik “Fisi Gold”është i

bazuar, mirepo tenderuesi i propozuar per dhenje te kontrates i permbush kerkesat e FDT-se pa e llogaritur kete reference.

Bazuar ne konstatimet paraprake u vendos si ne Dispozitiv te Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit